

PROCESVERBAL
nga seanca e 21-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 19.05.2025

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë përmes lidhjes video - konferencë:
Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë përmes lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr.Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga shërbimi profesional përmes lidhjes video-konferencë:
Goran Radunoviq, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, Lazo Petrushevski hapi seancën e 21-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt përmes lidhjes video-konferencë.

Z. Trajçev, në lidhje me Rendin e ditës të propozuar, vuri në dukje se pavarsisht diskutimeve të mëparshme në seanca lidhur me pikën „Të ndryshme“, ai ende nuk mund ta kuptonte plotësisht qëllimin e kryetarit të Këshillit për përjashtim të kësaj pike, e cila për vite me radhë kishte qenë pjesë e rregullt e Rendit të ditës. Ai rikujtoi se në seancën e mëparshme z. Petrushevski kishte arsyetuar të drejtën e tij si kryetar i Këshillit për të propozuar Rendin e ditës dhe për të vendosur për çështje të përfshirjes së pikave individuale. Z. Trajçev njoftoi se nuk do të propozonte më plotësim të Rendit të ditës me pikën „Të ndryshme“, megjithëse mbeti në dilemë rreth qëllimeve të vërteta dhe arsyeve për braktisjen e praktikës së vendosur dhe praktikës efikase. Ai vlerësoi se duke mos shtuar pikën „Të ndryshme“ në Rendin e ditës, kufizohet e drejta direkte e anëtarëve të Këshillit për të shprehur pikëpamjet, opinionet ose mendimet e tyre për çështje të caktuara që janë me rëndësi për punën e Këshillit. Ai përfundoi me qëndrimin se duke pasur parasysh përpjekjet e shumta që kjo pikë përsëri të jetë standarte dhe e rregullt nuk u pranua, ai nuk do të iniconte më përfshirjen e saj.

Z. Petrushevski deklaroi se sa herë që ndonjë nga anëtarët e Këshillit duhet të propozojë përfshirjen e pikës „Të ndryshme“ ose ndonjë pikë tjetër në Rendin e ditës, ai do t'i japë mundësinë që Këshilli të deklaron për plotësimin e propozuar.

Këshilli i Agjencisë, njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 20-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 15.05.2025.
2. Propozim për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR JON-RADIO SHPK Strugë.
3. Propozim për ndërprerje të procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR TV Shenja SHPKNJP Shkup.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 20-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 15.05.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR JON-RADIO SHPK Strugë. Ai theksoi se transmetuesi kishte detyrim ligjor për të kryer pagesë të kompensimit vjetor të lejes më së voni deri të mërkurën e kaluar, por ky detyrim nuk është përmbushur. Duke pasur parasysh këtë, ai propozoi që të fillojë procedura për heqjen e lejes në pajtim me dispozitat ligjore. Gjithashtu informoi se në komunikim me pronarin e radios, ai ka njoftuar se do të kryente pagesën gjatë periudhës shtesë prej 15 ditësh, të parashikuar për përmbushjen e detyrimit.

Këshilli i Agjencisë njëzëri inicioi procedurën për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive JON-RADIO SHPK Strugë, PA1 nr.08-301 datë 01.09.2023, për shkak të mospërmbushjes së detyrimit nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, përkatësisht për mospagesë të kompensimit vjetor të lejes për transmetim në radio të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele sipas faturës së dorëzuar me nr.2025-100-0128 datë 03.04.2025.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetor të lejes për transmetim në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive JON-RADIO SHPK Strugë, PA1 nr.08-301 datë 01.09.2023, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

Pika 3

Z. Petrushevski shpjegoi Propozimin për ndërprerje të procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR TV Shenja SHPKNJP Shkup. Ai theksoi se transmetuesi nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për pagesë të kompensimit në afatit e parashikuar prej 30 ditësh. Mrgjithatë, pas fillimit të procedurës për heqjen e lejes, transmetuesi

ka kryer pagesën e mjeteve. Duke pasur parasysh detyrimin e përmbushur, ai propozoi që procedura për heqjen e lejes të ndërpritet.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvenim për ndërprerje të procedurës për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV SHENJA SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-778 datë 07.09.2023.

Në pajtim me Njoftimin për pagesën e kryer me nr.05-2030/2 datë 15.05.2025, SHTR TV SHENJA SHPKNJP Shkup, kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv e pagoi plotësisht, sipas faturës së dorëzuar me nr.2025-100-0129 datë 07.04.2025.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**